

Znj. Bukuriye Sallaku

Në përgjigje të kërkesës tuaj për informacion, të depozituar pranë ISSH-së me nr./prot. 676, dt: 28.01.2021, sqarojmë se:

Për pyetjen: - *Në bazë të ditelindjes time (11.12.1956), a mund të filloj procedurat për pëfitimin e pensionit të pleqërisë?*

Në ligjin 7703, dt: 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 31, pika 1 është përcaktuar se:

Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji.

Referuar nenit 92, ju që jeni e datëlindjes 11.12.1956, ju ka lindur e drejta për përfitim pensioni pleqërie që në dt: 11.06.2017, në moshën 60 vjeç e 6 muaj dhe aktualisht nëse plotësoni kushtin ligjorë për periudhën e sigurimit mund të aplikoni në çdo kohë dhe e drejta e përfitimit të pensionit ju fillon nga data e paraqitjes së kërkesës.

(Referuar ligjit 7703, dt: 11.05.1993, neni 62, pika 2 në të cilin është përcaktuar se:

E drejta e pensionit nuk parashkruhet. Personi, i cili kërkon pensionin jo më vonë se 1 vit nga data që i lind kjo e drejtë, ky pension i paguhet që nga kjo ditë. Në raste të tjera pensioni do të paguhet nga data e paraqitjes së kërkesës për pension.)

Për pyetjen: - *Pas miratimit të ligjit nr.160/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore” a i ka filluar efektet një ligj i tillë dhe a njihen automatikisht vitet e kooperatives dhe kur ka mangësi vertetimet?*

Ligji nr.160/2020 “Për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore”, ka për qëllim njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish-kooperativat bujqësore, për të cilat është djegur dokumentacioni arkivor i vjetërsisë në punë, deri në hyrjen në fuqi të ligjit 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën", i ndryshuar.

Ky ligj ka hyrë në fuqi në dt: 08.01.2021 dhe aktualisht nuk ka hyrë në zbatim pasi janë duke u përgatitur aktet nën-ligjore për zbatimin e tij.